

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5444  
E premte, 6 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## Rama tërhiqet nga taksa për 'Rrugën e Kombit' ■ FAQE 2

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është tërhequr nga vendimi i tij për taksën në "Rrugën e Kombit" për banorët e zonës së Kukësit, duke premtuar se pagesa e tarifave në këtë aks rrugor nuk do të fillojë derisa të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**LISTA SERBE NUK E PRANON NISMËN E QEVERISË PËR ASOCIACIONIN** F. 6

**AVOKATI I POPULLIT NIS HETIMET PËR RASTIN E DEPORTIMIT TË SHTETASVE TURO** F. 7

**117 PRESONA KANË HUMBUR JETËN NGA MINAT** F. 5

### EKONOMI

**1 000 PUNËTORË TË POSTËS SË KOSOVËS ENDE NUK I KANË MARRË PAGAT** F. 9

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS SË SHPEJTI FILLON KONTROLLIMIN E GAZRAVE TË VETURAVE** F. 9

### KULTURË

**GASHI: TEATRI DHE BIBLIOTEKA NUK DO T'I KENË MË PROBLEMET E DERITASHME** F. 13

### SPORT

**REXHA: DEBATI PËR TRAJNERËT NGA SHQIPËRIA, I PANEVOJSHËM** F. 15

**AVDIJAJ: KAM REFUZUAR KLUBE TË MËDHA PËR SCHALKEN** F. 15

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI ■ FAQE 4-5

## Qeveria nuk lëkundet

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se dalja e Listës Serbe në opozitë nuk do ta lëkundë Qeverinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zgjedhjet e reja nuk janë në interes të agjendës shtetërore të Kosovës, duke shtuar se asnjëra prej partive politike shqiptare nuk

e ndien veten komode të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare. "Tani për tani as partnerët tanë nuk i mirëpresin zgjedhjet e reja dhe nuk mendoj se ato mund të ofrojnë zgjidhje", ka thënë Pajaziti, i cili e ka ftuar Listën Serbe të reflektojë dhe ta marrë përgjegjësinë që ia kanë dhënë qytetarët serbë të Kosovës në zgjedhje. Sipas tij, ky subjekt politik, me veprimet në ditët e fundit, po e defaktorizon veten



## Kërkohet unitet politik për përmbylljen e dialogut me Serbinë

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është proces i vështirë, por nuk ka alternativë. Kështu kanë deklaruar të enjten drejtuesit e institucioneve, përfaqësuesit e partive politike dhe diplomatët e huaj në konferencën "Skenarët e 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë". Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë thirrje për unitet politik në përmbylljen e dialogut me Serbinë. Sipas tyre, arritja e marrëveshjes përfundimtare duhet ta ketë peshën e njohjes reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



## ATK-ja dhe Dogana tejkaluan planin e të hyrave

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka shënuar rritje për 12.7 milionë euro apo

13.3 për qind më shumë këtë vit. Kurse Dogana gjatë periudhës janar-mars të këtij viti ka arritur në total vlerën rreth 212 milionë

euro. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të hyrat doganore kanë shënuar rritje për 2 për qind ■ FAQE 9

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çarëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GRUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Rama tërhiqet nga taksa për 'Rrugën e Kombit'

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është tërhequr nga vendimi i tij për taksën në "Rrugën e Kombit" për banorët e zonës së Kukësit, duke premtuar se pagesa e tarifave në këtë aks rrugor nuk do të fillojë derisa të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme

**TIRANË, 5 PRILL** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është tërhequr nga vendimi i tij për të mos negociuar me koncesionarin për rishikimin e pagesës së takës në "Rrugën e Kombit" për banorët e zonës së Kukësit. Rama u ka kërkuar ndjesë këtyre të fundit, me arsyen se Qeverisë së tij i ka munguar intuinta, siç e theksoi ai, për t'i dhënë sqarimet dhe shpjegimet për një vendimarrje të tillë. Megjithatë, kryeministri premtoi se pagesa e tarifave në këtë aks rrugor nuk do të fillojë derisa të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme. "Opozita e ka humbur rrugën dhe kërkon të

tërheqë sa më shumë njerëz në rrugën e tyre pa krye, por unë do të merrem me atë që është detyra jonë e ditës; shpjegimi me durim i çështjes që ka krijuar pakënaqësi të ligjshme të banorëve të zonës së Kukësit. Ajo që duhet përsëritur nga ana e Qeverisë, është vetëdija për përgjegjësinë time dhe tonën për pamjaftueshmërinë e shpjegimeve dhe sqarimeve lidhur me këtë çështje", tha Rama në foltoren e Kuvendit, ku në sallë mungonte opozita. Sipas tij, Qeveria nuk ka bërë sa duhet "jo pse kemi qenë indiferentë apo kemi lënë në harresë impaktin negativ që me të

drejtë ka shkaktuar kështu siç është paraqitur dhe manipuluar nga katër anëtar vendosja e pagesës në shpirtat e mendjet e njerëzve të zonës, por sepse nuk kemi pasur intuintën e duhur për ta kuptuar domosdoshmërinë e sqarimit të gjithë kësaj çështjeje para se të vendosej sistemi i pagesës".

Rama dha edhe arsyet pse Qeveria nuk ka dhënë shpjegime dhe pse nuk ka pasur intuintën e duhur për këtë çështje. "Pse kemi përgjegjësi unë i pari, Qeveria, për akumulimin e kësaj pakënaqësie? Sepse u kam kërkuar ndjesë publike banorëve të zonës dhe do t'ua



kërkoj deri në fund sa herë të flas për këtë temë, por i nisur thjesht nga praktika ndërkombëtare dhe duke qenë një përvojë e parë, nuk ishim të papërgatitur për çfarë mund të krijonte një risi e tillë nga pikëpamja psikologjike për njerëzit e painformuar sa duhet",

tha ai. Rama theksoi se në praktikën ndërkombëtare kërkohet gjashtë muaj për t'i nxjerrë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe për të trajtuar me një sistem të veçantë pagese përdoruesit e shpesh të qenë në këtë rast janë banorët e zonës.

# Samiti i BE-së për Ballkanin Perëndimor, drejt dështimit?

**BRUKSEL, 5 PRILL** - Samiti i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, që do të mbahet më 17 maj në Sofje, rrezikon të shndërrohet në një dështim të madh për bllokun derisa shtetet anëtare diskutojnë rreth faktit nëse takimi duhet të rezultojë me një deklaratë të përbashkët, apo diçka më të vogël.

Drafti i parë i së ashtuquajturës "Deklarata e Samitit të Sofjes", i krijuar nga 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe që është parë nga "Radio Evropa e Lirë", ka qenë temë e diskutimit për ambasadorët evropianë fillimisht në fund të muajit mars.

Ndonëse deri më tani, në draftin prej 13 paragrafesh, ka shumë pak përbashkësi politike, është e qartë se



pritet nuk do të jenë të mëdha, kur udhëheqësit evropianë të takohen me homologët e tyre nga Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, në takimin e tyre në kryeqytetin bullgar, pasi kanë kaluar më shumë se

15 vjet prej herës së fundit kur është mbajtur një samit i tillë.

Një prej pikave kryesore është prania e Kosovës në tavolinë, e cila përbën temë diskutimi për pesë shtete të BE-së, siç janë Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja, të

cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Dokumenti u referohet vendeve të BE-së si shtete, ndërsa gjashtë të tjera si "partnere të Ballkanit Perëndimor". Sipas burimeve, Spanja, ashtu sikurse Qiproja, Greqia dhe Rumania, nuk dëshirojnë që dokumentin ta cilësojnë si deklaratë dhe do të preferonin ta quanin "përfundimet e Presidencës bulgare", ose thjesht një deklaratë e nënshkruar nga shtetet e BE-së.

Disa nga mosnjohësit janë të pakënaqur me gjuhën e BE-së për zgjerim në këtë draft, në të cilin përmendet se "BE-ja konfirmon mbështetjen e qartë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe rruga evropiane

mbetet e bazuar në kritere dhe merita individuale", duke pretenduar se takimi i muajit maj nuk do të jetë për zgjerimin e BE-së.

Shtetet e tjera, që kanë më shumë prirje për atë që shtetet e Ballkanit Perëndimor t'i bashkohen BE-së, sikurse Austria, Kroacia dhe Italia, janë duke shtyrë përpara gjuhën ambicioze për t'i ruajtur deklaratat e Samitit të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Selanik, në vitin 2013, ku është thënë se të gjitha shtetet në rajon do të bëhen një ditë anëtare të BE-së.

Në draft është përmendur mbështetja për projektin që lidh zonat bregdetare të Kroacisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë, si dhe projektin "Autostrada e paqes" që lidh Nishin me Prishtinën.

## Donald Lu: Nuk ofrojmë financim për Sorosin

**TIRANË, 5 PRILL** - Organizata "Judicial Watch", në një njoftim të botuar të mërkurën, akuzon Departamentin e Shtetit se ka ndihmuar me fonde organizatat e filantropit Xhorxh Soros për aktivitetet politike në mbështetje të forcave të majta në Shqipëri. "Judicial Watch" një organizatë konservatore, e cila vëzhgon abuzimet e mundshme të buxhetit federal në ShBA, i bazon akuzat

mbi dokumentet e brendshme të Departamentit të Shtetit të siguruarara përmes së drejtës së informimit.

"Judicial Watch" thotë se fonde prej rreth 9 milionë dollarësh të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) i janë kaluar Fondacionit "Soros" në Shqipëri gjatë vitit 2016 që, sipas "Judicial Watch", synonin t'i jepnin qeverisë socialiste kontroll

më të madh mbi sistemin e drejtësisë përmes reformës në drejtësi.

"Judicial Watch" akuzon ambasadorin Donald Lu si të lidhur ngushtë me Sorosin dhe me Qeverinë socialiste në Shqipëri.

Ipyetur nga "Zëri i Amerikës", se si u përgjigjet këtyre kritikave, ambasadori Lu thekson se "ne nuk kemi ofruar financime për Fondacionin Shoqëria e Hapur dhe as kemi manë financime prej saj".





Është mbajtur konferenca "Skenarët e 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë"

# Kërkohet unitet politik për përmbylljen e dialogut me Serbinë



Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është proces i vështirë, por nuk ka alternativë. Kështu kanë deklaruar të enjten drejtuesit e institucioneve, përfaqësuesit e partive politike dhe diplomatët e huaj në konferencën "Skenarët e 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë". Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë bërë thirrje për unitet politik në përmbylljen e dialogut me Serbinë. Sipas tyre, arritja e marrëveshjes përfundimtare duhet ta ketë peshën e njohjes reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

**EPOKA E RE**

**Shqipe HETEMI**

**PRISHTINE, 5 PRILL** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se përmbyllja e dialogut politik me Serbinë me marrëveshjen ligjërish obliguese është interes nacional i Kosovës që nuk njihet vijat ndarëse qeveritare dhe opozitare. Ai ka kërkuar unitet politik për përmbylljen e dialogut me Serbinë. "Ky do të jetë një proces i vështirë, por nuk ka alternativë. Bisedimet me Serbinë, ashtu siç e kanë bërë bashkë politikën e Kosovës në Konferencën e Rambujesë dhe në Procesin e Vjenës, do të duhej të na bashkonin edhe tash në finalen e Brukselit. Kjo është zgjidhja më e mirë për politikën e Kosovës, sepse ky unitet politik është i domosdoshëm. Në këtë proces ne duhet të jemi të bashkuar për ta mbyllur këtë kapitull të rëndë dhe tragjik

historik, që t'i hapim udhë Kosovës që të jetë shtet i barabartë me të gjitha shtetet e tjera në OKB, në BE dhe në NATO. Përmbylljen e këtij qëllimi ua kemi borxh qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar Thaçi në konferencën "Skenarët e 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", e cila është organizuar nga Instituti RIDEA, Instituti BPRG, e mbështetur nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë. Presidenti Thaçi ka thënë se ka ardhur koha për arritjen e marrëveshjes së madhe politike dhe historike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, kjo marrëveshje ka peshën e njohjes reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Në aspektin kohor, edhe në bazë të terminologjisë së përdorur në 'Strategjinë për zgjerimin e BE-së' flasim për një urgjencë në arritjen e marrëveshjes ligjërish obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Urgjencja për ne dhe për Brukselin, të shprejshëm edhe për Beogradin, nënkupton që ky vit të jetë kornizë kohore për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Sa i përket përmbajtjes së marrëveshjes, ajo tashmë njihet një 'kod' të vetin politik dhe diplomatik, me titullin e një 'marrëveshjeje ligjërish obliguese'. Për ne në Kosovë kjo marrëveshje ka peshën e njohjes reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe normalizimit e plotë të marrëdhënieve në mes të dy shteteve", është shprehur Thaçi, duke shtuar se kjo marrëveshje duhet t'i mundësojë Kosovës të bëhet shtet anëtar i OKB-së, i OSBE-së dhe i të gjitha organizatave ndërkombëtare. Ai ka thënë se marrëveshja ligjërish obliguese në mes të dy vendeve do të duhej ta sillte edhe njohjen nga pesë shtetet e BE-së, si dhe një dinamikë të përshpejtuar të anëtarësimit të Kosovës në BE dhe në NATO. "BE-ja dhe ShBA-ja së bashku do të duhej të jenë garantues jo vetëm për arritjen e kësaj marrëveshjeje të madhe, por edhe të zbatimit të saj, me afate shumë konkrete kohore", ka theksuar Thaçi. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se finalja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë njohja reciproke. Ai ka thënë se duhet të ketë unitet politik e institucional dhe të gjithë udhëheqësit politikë është mirë të jenë pjesë e këtij dialogu. "Finalja është një,

është njohja reciproke e cila duhet të ndodhë. Kush e ka guximin, fuqinë apo ndonjë instrument le të ndihmojë. Kush nuk e ka, duhet t'i thotë Kosovës shko rrugës tënde dhe, kur e thotë këtë, atëherë shqiptarët në Ballkan duhet ta pyesin veten se a mund të ecim kështu si jemi apo çfarë duhet të bëjmë. Pra, duhet të vijë një ditë e të na thotë dikush, vendosni për vete. Ky është një realitet që duhet ta kuptojmë, sepse kanë kaluar dy dekada, 20 vjet në Evropë dhe po na thonë po e vazhdojmë dialogun. Deri kur?! Nëse Brukseli zyrtar nuk ka kapacitet për ta mbyllur këtë temë le të kërkojë ndihmë ose nëse nuk dëshiron ndihmë, të na tregojë se çka të bëjmë ne dhe ne shkojmë në drejtimin tonë ashtu sikur kemi ditur ta bëjmë në të kaluarën", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërsa nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se problemi i Serbisë ndaj Kosovës është territorial. Ai ka theksuar se shteti serb, në pamundësi të spastrimit etnik në forma të tjera, po tenton ndarjen e Kosovës. "Problemi i Serbisë është territorial, sepse në pamundësi të spastrimit etnik në forma të tjera, po tenton ndarjen e Kosovës për ta larguar nga harta të arriturën e Kosovës", ka thënë Haziri. Kurse kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se Kosova nuk duhet të lëshojë pe në marrëveshjet me Serbinë, për të siguruar në të ardhmen një ulësë në OKB, apo në ndonjë organizatë tjetër. Sipas tij, më i rëndësishëm është bashkimi i Mitrovicës sesa ulësja në OKB.

## Delawie: Dialogu nuk ka alternativë tjetër

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Greg Delawie, ka thënë se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka sjellë përfitime për shtetin e Kosovës. Por, sipas tij, këtë vit duhet të bëhet përparim në këtë proces. "Dialogu në mes të Kosovës e Serbisë ka sjellë

me të vërtetë përfitime të mira për vendin. Nuk ka ndonjë alternativë përveç negociatave dhe kompromisit mes të dy vendeve. ShBA-ja mbështet aspiratat e Kosovës e të Serbisë për t'u bashkuar në Bashkimin Evropian. Këtë vit duhet të bëhet përparim në dialog", ka thënë Delawie.

Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

# Qeveria nuk lë

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se dalja e Listës Serbe në opozitë nuk do ta lëkundë Qeverinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zgjedhjet e reja nuk janë në interes të agjendës shtetërore të Kosovës, duke shtuar se asnjëra prej partive politike shqiptare nuk e ndien veten komode të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare. "Tani për tani as partnerët tanë nuk i mirëpresin zgjedhjet e reja dhe nuk mendoj se ato mund të ofrojnë zgjidhje", ka thënë Pajaziti, i cili e ka ftuar Listën Serbe të reflektojë dhe ta marrë përgjegjësinë që ia kanë dhënë qytetarët serbë të Kosovës në zgjedhje. Sipas tij, ky subjekt politik, me veprimet në ditët e fundit, po e defaktorizon veten

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë se dalja e Listës Serbe në opozitë nuk do ta lëkundë Qeverinë aktuale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pajaziti ka vlerësuar se të gjitha subjektet politike shqiptare duhet të heqin dorë prej interesit të ngushtë dhe ta shikojnë interesin shtetëror. "Agjenda e shtetit të Kosovës duhet të vazhdojë të ecë përpara me këtë Qeveri, me këtë opozitë dhe me këto parti politike. Bile ky rast duhet të shërbejë për vetëdijesimin e Listës Serbe se e ardhmja e vendit tonë nuk do të ngecë dhe nuk do të varet nga tendenca e Beogradit për ta manipuluar agjendën e institucioneve të Kosovës përmes deputetëve që i ka në parlament", ka thënë Pajaziti.

Ai ka deklaruar se Lista Serbe me veprimet e fundit po e defaktorizon veten. "Pavarësisht se çfarë ka në mendje Lista Serbe, mënyra se si ka vepruar kohët e fundit, jo që e ka fuqizuar veten deri aty sa të jetë faktor për ndryshimin e qeverive, por e ka dobësuar si kurrë më parë pozicionin e vet. Bile e ka komprometuar edhe rolin e vet, i cili do të duhej të ishte kyç në hapat e mëtejme që kanë të bëjnë me asociacionin dhe disa vendime të tjera të institucioneve tona në proceset integruese. Pra, Lista Serbe po e degradon, po e dëmton dhe po e shfuqizon vetveten dhe rolin e vet në Kosovë", është shprehur Pajaziti. Deputeti i PDK-së ka mohuar

mundësinë që vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja. Sipas tij, mbajtja e zgjedhjeve të reja nuk ofron zgjidhje. "Askush në Kosovë nuk e ndien veten komod që të hyjë tani në proces zgjedhor, aq më tepër qytetarët e Kosovës që vitin e kaluar kanë dalë në dy palë zgjedhje. Pra, askush nuk e pret një gjë të tillë", ka thënë Pajaziti, duke shtuar se zgjedhjet e reja nuk i mbështesin as ndërkombehtarët. Megjithatë, Pajaziti ka pranuar se askush nuk mund t'u ikë procedurave demokratike. "Ne nuk mund t'u ikim procedurave demokratike që janë të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Kushdo qofshin ata, nëse i përmbushin procedurat ligjore, ne nuk mund t'u ikim atyre. Në këtë rast edhe zgjedhjet nuk janë tabu. Të gjithë duhet të jemi të gatshëm të përballemi me diçka që është ligjore dhe kushtetuese. Mendoj se tani ne duhet t'i shikojmë interesat e vendit dhe të qytetarëve, të cilat na thonë se ne nuk duhet t'u ikim përgjegjësisë tona", ka thënë Pajaziti.

**"Epoka e re":** Z. Pajaziti, pas daljes së Listës Serbe, Qeveria e Kosovës nuk e ka shumicën e nevojshme në Kuvend. Cili është qëndrimi i PDK-së ndaj kësaj shtate?

**Pajaziti:** Nuk jemi në kohë edhe aq komode të vajtimin të numrave. Tani do të duhej të mos i vendosim në rend të parë qëllimet partiake, por interesat parësore të vendit. Mendoj se koalicionit qeverisës do t'i duhet një kohë tjetër e vlerësimit të punës, përpos vlerësimeve të përhershme që duhet t'i bëhen nga Kuvendi dhe qytetarët. Tani është koha



të parandalojmë të gjitha përpjekjet e mbrapshta të tjerëve, duke përfshirë këtu edhe Listën Serbe, në proceset e rëndësishëm nëpër të cilin po kalon Kosova që ka të bëjë me integrimin e vendit tonë dhe zbatimin e disa kriterëve për ecje përpara. Më shumë se sa numrat në Kuvend, tani është e rëndësishme që i gjithë spektri politik, pozitë dhe opozitë, të fokusohen seriozisht në sfidat e ardhshme, në një moment tjetër pastaj të trajtohet edhe performanca e Qeverisë dhe ecja përpara.

**"Epoka e re":** Po mendoni se Lista Serbe me këto veprime po tenton të bëjë obstrukcione në rrugën e Kosovës drejt

integriteteve evropiane?

**Pajaziti:** Pavarësisht se çfarë ka në mendje Lista Serbe, mënyra se si ka vepruar kohët e fundit jo që e ka fuqizuar veten deri aty sa të jetë faktor për ndryshimin e qeverive, por e ka dobësuar si kurrë më parë pozicionin e vet. Bile e ka komprometuar edhe rolin e vet i cili do të duhej të ishte kyç në hapat e mëtejme që kanë të bëjnë me asociacionin dhe disa vendime të tjera të institucioneve tona në proceset integruese. Pra, Lista Serbe po e degradon, po e dëmton dhe po e shfuqizon vetveten dhe rolin e vet në Kosovë.

**"Epoka e re":** Dalja e këtij subjekti politik në opozitë, do

ta lëkundë Qeverinë?

**Pajaziti:** Besoj se tani i gjithë spektri politik në Kosovë është i vetëdijshëm se çfarëdo lloj qeverie të ishte do të duhej të përballje me sfidat që janë para nesh. Askush në Kosovë nuk e ndien veten komod që të hyjë tani në proces zgjedhor, aq më tepër qytetarët e Kosovës që vitin e kaluar kanë dalë në dy palë zgjedhje. Pra, askush nuk e pret një gjë të tillë. Lista Serbe, pavarësisht prej qëndrimit të vet, do të detyrohet të kthehet në agjendën e cila, në radhë të parë, është në interes të qytetarëve serbë. Ata nuk mund të determinojnë kahun e jetës politike në Kosovë. Orientimi ynë është ai që presin partnerët tanë dhe BE-ja. Pra, të



# kunddet



merremi me përmbushjen e kriterit të fundit që ka të bëjë me liberalizim të vizave dhe me proceset e tjera integrale.

**"Epoka e re":** *Largimi i ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, sa mund të ndikojë në kthimin e Listës Serbe në Qeveri, sepse largimi i Sefajt ka qenë edhe kërkesë e këtij subjekti politik pas ngjarjeve në veri?*

**Pajaziti:** Tani dua të bëj një analogji me ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Pavarësisht se si rrodhën situatat dhe çfarë u mor si rrethanë lehtësuese për t'u arritur një pajtim më i gjerë, në fund u bë mirë që ishin votat e nevojshme për

ratifikimin e kësaj marrëveshje. Edhe në rastin e Listës Serbe, çfarëdo që ata të marrin si arsye që të kthehen në Qeveri, nuk është fare e rëndësishme. E rëndësishme është që ata të kthehen dhe t'i marrin përgjegjësitë që ua kanë dhënë qytetarët serbë të Kosovës dhe jo të marrin përgjegjësi të cilat ua jep Beogradi për interesa të ngushta politike.

**"Epoka e re":** *Sa duhet të pritët Lista Serb që të kthehet në Qeveri?*

**Pajaziti:** Agjenda e shtetit të Kosovës duhet të vazhdojë të ecë përpara me këtë Qeveri, me këtë opozitë dhe me këto parti politike. Bile ky rast duhet të shërbejë për vetëdijesimin e

Listës Serbe se e ardhmja e vendit tonë nuk do të ngeçë dhe nuk do të varet nga tendenca e Beogradit për të manipuluar me agjendën e institucioneve të Kosovës përmes deputetëve që i ka në Kuvend.

**"Epoka e re":** *Ju e mohuat mundësinë e shkuarjes së vendit në zgjedhje të reja, mirëpo LDK-ja vazhdimisht po kërkon zgjedhje të reja duke përmendur edhe mundësinë e një mocioni ndaj Qeverisë?*

**Pajaziti:** Ne nuk mund t'u ikim procedurave demokratike që janë të parapara me ligj dhe Kushtetutë. Kushdo qofshin ata, nëse i përmbushin procedurat ligjore, ne nuk mund t'u ikim atyre. Në këtë rast edhe zgjedhjet nuk janë tabu. Të gjithë duhet të jemi të gatshëm që të përballemi me diçka që është ligjore dhe kushtetuese. Mendoj se tani duhet t'i shikojmë interesat e vendit dhe të qytetarëve, të cilat na thonë se ne nuk duhet t'u ikim përgjegjësisë tona. Në këtë rast, do të duhej të kemi pjesëmarrje më aktive edhe të opozitës në proceset e rëndësishme për vendin, siç është dialogu me Serbinë dhe proceset e tjera që na presin. Tani për tani as partnerët tanë nuk i mirëpresin zgjedhjet e reja dhe nuk mendoj se ato mund të ofrojnë zgjidhje, apo një spektër tjetër politik i cili do t'u jepte një përgjigje tjetër këtyre sfidave që i kemi përpara.

**"Epoka e re":** *Meqenëse zgjedhjet nuk qenkan zgjidhje dhe tani Qeveria nuk e ka shumicën, keni menduar për ndonjë zgjerim të koalicionit qeverisës?*

**Pajaziti:** Jo. PDK-ja nuk ka diskutuar për diçka të tillë. Për neve është shumë me rëndësi që synimet programore t'i çojmë përpara dhe ta realizojmë agjendën evropiane, sepse në këtë agjendë përfshihen disa çështje që janë të rëndësishme e të cilat kanë të bëjnë me fuqizimin e sundimit të ligjit, zhvillimin ekonomik dhe me formimin e ushtrisë. Ne nuk kemi pasur ndonjë diskutim të veçantë për çështje të reformimit të Qeverisë. Është në dorën e kryeministrit, në bashkëpunim me partnerët e koalicionit, që brenda këtij koalicioni ta bëjë më të mirën e mundshme, në mënyrë që të përballemi me këtë agjendë e cila nuk është e aspak e lehtë.

## 117 presona kanë humbur jetën nga minat

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Që nga viti 1999 në Kosovë janë pastruar 51 216 mijë metra katrorë tokë dhe janë asgjësuar mbi 88 000 mina dhe mjete eksplozive të pashpërthyer. Nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer kanë humbur jetën 117 qytetarë si dhe kanë marrë lëndime të rënda 463 veta. Kështu është bërë me dije të

enjtën me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Vetëdijesimit të Rrezikut nga Minat dhe Mjetet e Tjera të Pashpërthyer. Në shënimin e kësaj dite kanë marrë pjesë Shkolla Ndërkombëtare e Eliminimit të Mjeteve të Pashpërthyer (EOD) në Kosovë, MAT Kosova, HALO Trust dhe NPA.



## Berisha merr mbështetjen e Francës për FSK-në

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha, ka pritur të enjtën në një takim ambasadorin e Francës në Prishtinë, Didier Chabert, të cilin e ka njoftuar me zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme të kësaj ministrie dhe të FSK-së. Po ashtu, ministri Berisha e ka njoftuar ambasadorin Chabert edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar që ka FSK-ja me NATO-n, KFOR-in, NALT-in, ShBA-në,

shtetet anëtare të NATO-s si dhe për zhvillimet rreth transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosura të Kosovës. Ndërsa ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka konfirmuar gatishmërinë e Francës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin dhe shtimin e bashkëpunimit në muajt në vazhdim, duke filluar me vizita të delegacioneve zyrtare, identifikimin e fushave të bashkëpunimit me interes të përbashkët për të dy shtetet.





# Lista Serbe nuk e pranon nismën e Qeverisë për Asociacionin

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Lista Serbe ka reaguar ndaj nismës së Qeverisë së Kosovës për ta riaktivizuar ekipin menaxherial i cili do ta bëjë draftimin e statutit për Asociacionin e Komunave Serbe. Kjo parti përmes një reagimi për medie ka bërë me dije se për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe janë të vlefshme vetëm marrëveshjet e arritura në Bruksel.

Lista Serbe që përfaqëson serbët në institucionet e Kosovës, ka bërë me dije se janë të papranueshme disa akte që shërbejnë për përdorim të brendshëm. Sipas Listës Serbe, për draftimin e statutit të Asociacionit i vetmi që ka kompetencë është ekipi menaxhues i përbërë nga katër përfaqësues të serbëve, në përputhje me marrëveshjen e arritur në Bruksel.

Gjithashtu, në këtë komunikatë thuhet se Lista Serbe dhe Qeveria e Serbisë janë skeptike dhe pesimiste sepse në Prishtinë nuk ka vullnet të vërtetë për zbatimin e plotë të marrëveshjes dhe për formimin e Bashkësisë së Komunave Serbe. "Aktivitetet që po paralajmërohen kanë efektin e

kinse, përpjekjes së përfaqësuesve të shqiptarëve, në mënyrë që ta zvogëlojnë presionin ndërkombëtar, pa ndonjë dëshirë që marrëveshja e Brukselit të realizohet konkretisht", është bërë me dije në komunikatën e Listës Serbe. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, bashkë me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, kanë riaktivizuar të mërkurën ekipin menaxherial i cili do ta bëjë draftimin e statutit për Asociacionin e Komunave Serbe. Draftimi i statutit do të jetë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës, i cili do të përbëhet nga tre mekanizma punues: ekipi menaxhues, komiteti zbatues si dhe grupi nacional konsultativ, të cilët do të garantojnë përfshirje të gjithë spektrit politik, të shoqërisë civile dhe të mekanizmave të tjerë relevantë të shoqërisë.

Në këtë proces do të jenë të përfshirë edhe mekanizma ndërkombëtarë, të cilët e kanë ndihmuar Kosovën në të gjitha fazat dhe ky do të jetë një hap i rëndësishëm i Kosovës në rrugën e saj të integrimi euroatlantike. Drafti final i statutit, në fund të pro-



cesit, bashkë me direktivën, do të dërgohen në Gjykatën Kushtetuese për t'u siguruar se janë në

përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kosova me këtë hap përmbush edhe një

obligim ndërkombëtar, duke dëshmuar përkushtimin në rrugën euroatlantike.

## BE-ja mirëpret riaktivizimin e ekipit menaxherial për Asociacionin

Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka thënë se kanë mirëpritur njoftimin e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, për t'ia dhënë mandatin ekipit menaxherial për hartimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kocijançiq ka bërë me dije se ky hap, i prituri kohë të gjatë, krijon mundësinë e zbatimit të marrëveshjes për Asociacionin, i cili është obligim

i Kosovës në kuadër të marrëveshjeve të arritura në Bruksel nga prilli i vitit 2013 deri në gusht të vitit 2015.

Ajo ka thënë se Bashkimi Evropian do t'i ftojë shefat negociatorë nga Prishtina dhe Beogradi, ekipet e tyre dhe ekipin menaxherial, duke përfshirë ekspertë, për të diskutuar në Bruksel dhe për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim për procesin e hartimit të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

## Kryetarët e degëve të LDK-së kërkojnë që vendi të shkojë në zgjedhje



**PRISHTINË, 5 PRILL** - Kryetarët e degëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në mbledhjen e mbajtur të enjten kanë vlerësuar se vendi ka hyrë në krizë të thellë institucionale dhe politike. "Është e qartë se Qeveria e pakicës nuk mund të udhëheqë vendin dhe se temat e rëndësishme për vendin nuk mund të adresohen nga një qeveri e rënë", është thënë në komunikatën e LDK-së. Sipas kësaj komunikate, kryetarët e

degëve të LDK-së kanë shtuar përgatitjet për zgjedhjet e parakohshme. "Në ditët në vijim kryesia e LDK-së do të jetë në secilën degë të saj për të komunikuar me strukturat e degëve dhe për t'i shtuar përgatitjet për zgjedhje. Degët e LDK-së janë të gatshme t'i nënshtrohen procesit zgjedhor dhe janë të bindura në mbështetjen e qytetarëve", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

## Kai Eide dekorohet me Medaljen Presidenciale

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka prituri të enjten në takim ish të dërguarin e posaçëm të sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në vitin 2005, ambasadorin Kai Eide. Për kontributin e tij në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, presidenti Thaçi e ka dekoruar ambasadorin Eide me

Medaljen Presidenciale Jubilarë të dhjetëvjetorit të pavarësisë.

Thaçi ka thënë se të gjitha sukseset e Kosovës, që nga liria deri te shtetndërtimi, janë ndërmarrje e përbashkët e popullit të Kosovës dhe miqve të shumtë që i ka Kosova në tërë botën. Ndërsa ambasadori Kai Eide ka thënë se është i nderuar me vizitën dhe dekoratën presiden-

ciale si dhe ka përgëzuar presidentin Thaçi dhe popullin e Kosovës për të arriturat në dy dekadat e fundit.

Raporti i ambasadorit Eide mbi situatën politike në Kosovë për sekretarin e atëhershëm të OKB-së, Kofi Annan, rezultoi me fillimin e negociatave për përcaktimin e statusit, proces që përfundoi me pavarësinë e Kosovës.





# Avokati i Popullit nis hetimet për rastin e deportimit të shtetasve turq

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Dyshimet e ngritura, se janë shkelur standardet ndërkombëtare të lirisë dhe të drejtave të njeriut, e kanë shtyrë Avokatin e Popullit të Kosovës t'i nisë hetimet lidhur me deportimin e gjashtë qytetarëve turq javën e kaluar. Autoritetet e sigurisë në Kosovë, nën arsyetimin se këta persona paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, fillimisht ua revokuan të njëjtëve të drejtën e qëndrimit dhe më pas i deportuan nga Kosova për në Turqi, në bashkëpunim me inteligjencën turke.

Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka thënë se veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të



Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka vlerësuar se deportimi i gjashtë shtetasve turq është bërë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Ai ka bërë me dije se ka nisur hetimet për këtë rast. Jashari ka thënë se është herët të flitet për rezultatet e këtyre hetimeve pasi, sipas tij, aktualisht janë duke u marrë informacione nga të gjitha institucionet që kanë qenë të përfshira në këtë rast

drejtat dhe liritë e njeriut, të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se janë përcjellë edhe shqetësimet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve vendore, përkatësisht Ligjit për të huajt. Në një vlerësim preliminar, sipas tij, është vërejtur që këto ligje nuk janë zbatuar. Jashari ka thënë se

kanë qenë shqetësimet e përcjella nga anëtarët e familjeve të personave që janë dëbuar nga Kosova, që e kanë shtyrë këtë institucion t'i nisë hetimet. "Kam vendosur të hapim hetime në momentin kur kemi kuptuar se ata janë deportuar nga Kosova. Kjo, për mendim tim, është në kundërshtim të plotë me

standardet ndërkombëtare që janë të zbatueshme në Kushtetutën e Kosovës dhe kjo konsiderohet një prej shkeljeve më të rënda që ka të bëjë me mbrojtjen nga keqtrajtimi, turpërimi, trajtimi ç'njerëzor dhe degradues që është neni 3 i Konventës Evropiane dhe aspektet procedurale që lidhen me zbatimin e këtij neni", ka thënë Jashari.

Avokati i Popullit ka bërë me dije se është herët të flitet për rezultatet e këtyre hetimeve, mirëpo ka shtuar se janë duke marrë informacione nga të gjitha institucionet që kanë qenë të përfshira në këtë rast.

"Është vështirë për të folur dhe për t'i paragjykuar tash hetimet dhe veprimet që jemi duke ndërmarë, mirëpo jemi në fazën e mbledhjes se të gjitha informatave të të gjitha institucioneve relevante që kanë qenë të përfshira në këtë proces dhe jemi duke e hetuar atë që është më e rëndësishme, procesin e vendimmarrjes dhe zbatimin e procedurave ose jo të autoriteteve që kanë qenë të thirrura për ta kryer këtë procedurë në pajtueshmëri me këto standarde që unë i përmenda", ka theksuar Jashari. Avokati i Popullit ka thënë se deportimi i këtyre gjashtë personave do të duhej bërë duke respektuar

të gjitha procedurat. "Në asnjë shtet nuk mohohet mundësia për të deportuar ose për të ekstraduar një person, mirëpo jo pa i përcjellë hapat proceduralë që garantohen edhe me ligje vendore dhe ky është shqetësimi kryesor, jo vetëm i imi, po besoj edhe i të gjitha institucioneve dhe organizatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut", është shprehur Jashari. Më 29 mars Policia e Kosovës ka arrestuar dhe dëbuar në Turqi gjashtë qytetarë turq, pesë prej tyre punonjës në shkollën "Mehmet Akif", ndërsa i dëbuar i gjashtë ishte mjek turk.

## Lumezi e Havolli koordinohen për parandalimin e korrupsionit

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka pritur të enjten në takim drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havollin, drejtorin për Parandalimin e Korrupsionit, Afrim Atashin, si dhe drejtorin e Departamentit për Luftimin e Korrupsionit, Blerim Kelmendin. Në kuadër të veprimeve të përbashkëta, kryeprokurori Lumezi dhe drejtori Havolli kanë diskutuar për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit 2018-2022, për plotësimet dhe ndryshimet e pritura në legjislacionin kundër korrupsionit.

Lumezi e Havolli kanë diskutuar edhe për aspektet që ndërlidhen me parandalimin dhe elimin-

imin e shkaqeve të korrupsionit përmes deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Po ashtu, ata kanë diskutuar për parandalimin e shfaqjes së situatave të konfliktit të interesit si dhe ngushtimit të hapësirave për korrupsion në prokurimin publik.

Ndërkaq kryeprokurori Lumezi ka thënë se prioritet kryesor i Prokurorit të Shtetit është ndjekja e suksesshme e veprave penale që ndërlidhen me krim të organizuar dhe kundër ekonomisë. Po ashtu, Lumezi ka theksuar se mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare është vepër penale. Ai ka thënë se në këtë drejtim prokurori i shtetit do ta ndërmarë ndjekjen penale ndaj atyre që nuk deklarojnë apo bëjnë deklaram të rrejshëm të pasurisë.





# 1 000 punëtorë të Postës së Kosovës ende nuk i kanë marrë pagat

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Kryesia e Shoqatës Sindikale të Punëtorëve të Postës së Kosovës, për shkak të mosekzekutimit të pagave me pesë ditë vonë, përmes një komunikate për media i është drejtuar Bordit të Postës së Kosovës dhe aksionarit, Qeverisë së Kosovës, që t'i shtojnë përpjekjet për përmirësimin e gjendjes financiare të Postës së Kosovës, në të kundërtën nga java e ardhshme do të detyrohen të ndërmarrin hapa sindikalë deri në ekzekutimin e pagave. "Duke pasur parasysh gjendjen e vështirë financiare nëpër të cilën po kalon Ndërmarrja Publike, Posta e Kosovës Sh. A., si dhe duke pasur parasysh

mosekzekutimin e pagave të punëtorëve edhe sot, që i bie pesë ditë me vonë, ne ju drejtohem përmes kësaj komunikate: Menaxhmentit të lartë, Bordit të Postës së Kosovës, si dhe aksionarit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, që t'i rrisin përpjekjet e tyre maksimale për gjetjen e zgjidhjes afatgjatë, për ta përmirësuar gjendjen financiare të Postës së Kosovës, nga e cila sigurohet mirëqenia e mbi 1 000 familjeve që ekskluzivisht janë të varur nga paga e Postës së Kosovës", thuhet në reagimin e Sindikatës së Postës.

Kryesia e Shoqatës Sindikale të Punëtorëve të Postës së Kosovës

ka kërkuar përkrahje maksimale për fuqizimin e Postës së Kosovës. "Në emër të Punëtorëve të Postës së Kosovës kërkojmë përkrahje maksimale për fuqizimin e Postës së Kosovës, si një e drejtë e garantuar me ligj për operatorin publik dhe përmes zbatimit të kontratave të shërbimeve postare, e cila ngre kredibilitetin e shtetit të Kosovës si ndërmarrje publike. Ne kërkojmë përkrahje për punë, që përmes saj të arrijmë dhe ta kemi mirëqenien tonë si çdo punëtor dhe ndërmarrje tjetër publike", është theksuar në komunikatën e Kryesisë së Shoqatës Sindikale të Punëtorëve të Postës së Kosovës.



## Ministria e Infrastrukturës së shpejti fillon kontrollimin e gazrave të veturave



PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Me ftesë të "RIT Kosova" (A.U.K), ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka mbajtur të enjten një ligjëratë me temën "Ndotja e ajrit, sfidat dhe veprimet", ku ka prezantuar veprimet e saj në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë. Me këtë rast, Reshitaj ka thënë se qysh në fillim të mandatit ka filluar hapat konkretë për përmirësimin e cilësisë së ajrit. "Hartimi i planit të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit, identifikimi i ndotësve më të mëdhenj në Prishtinë, largimi i përdorimit të thëngjillit

për ngrohje në institucione edukativo-arsimore, ndalimi i qarkullimit të veturave për dy ditë në zonën e parë të kryeqytetit dhe subvencionimi i transportit publik janë disa nga veprimet e para që kam ndërmarrë si ministre për reduktimin e ndotjes së ajrit", ka thënë Reshitaj. Ajo ka folur edhe për krijimin e task forcës për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe për rezolutën e Kuvendit, duke shpalosur vendimet që kjo taskë forcë ka marrë në takimin e parë. "Ministria e Infrastrukturës shumë shpejt fillon kontrollimin

e gazrave të veturave. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nga ky vit ndalon përdorimin e thëngjillit për ngrohje në shkolla. Ministria e Shëndetësisë ka iniciuar krijimin e komitetit për shëndet mjedisor dhe të sistemit informativ shëndetësor. Po ashtu, kanë filluar inspektimet e rrepta nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për kontrollimin e cilësisë së derivateve të naftës", ka thënë ajo. Sipas ministres Reshitaj, me kërkesën e MMPH-së Ministria e Punëve të Brendshme ka iniciuar krijimin e policisë së gjelbër.

## ATK-ja realizon seminarin për OJQ-të

PRISHTINË, 5 PRILL - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bashkëpunim me "Save the Children", ka organizuar seminar njëditor për organizatat joqeveritare me temë "Procedurat e raportimit dhe obligimet e OJQ-ve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës". Në këtë seminar janë trajtuar temat: "Tatimi në paga dhe kontributet pensionale", "Tatimi në qira", "TVSh-ja dhe rimbursimi i TVSh-së", "Tatimi në korporata - deklarimi vjetor CD" dhe "Raportimi i blerjeve mbi 500 euro". Sipas ASK-së, qëllimi i mbajtjes së këtij seminary ishte që OJQ-të të njoftohen për së afërmi lidhur me temat e lartcekura. "Gjatë këtij seminary pjesëmarrësit parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me temat e prezantuara, si dhe pyetje të tjera lidhur me legjislacionin tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit janë ofruar përgjigje adekuatë nga prezantuesit e seminarit", është thënë në njoftimin e ATK-së.





# ATK-ja dhe Dogana tejkaluan planin e të hyrave

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka shënuar rritje për 12.7 milionë euro apo 13.3 për qind më shumë këtë vit. Kurse Dogana gjatë periudhës janar-mars të këtij viti ka arritur në total vlerën rreth 212 milionë euro. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, të hyrat doganore kanë shënuar rritje për 2 për qind

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINE, 5 PRILL - Dy institucionet kompetente për grumbullimin e të hyrave në Kosovë, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, kanë tejkaluar planin e të hyrave për tremujorin e parë të këtij viti. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka vazhduar me rritje të performancës, ku vetëm gjatë muajve janar-mars 2018 nga të hyrat e rregullta ka arkëtuar 107.7 milionë euro.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ATK-ja ka shënuar rritje për 12.7 milionë euro apo 13.3 për qind më shumë. Ndërsa në raport me planin e të hyrave, ATK-ja ka mbledhur 5.3 për qind më shumë të hyra. "Të hyra të njëhershme nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) gjatë muajit janar janë arkëtuar 9.97 milionë euro, të cilat nuk janë përfshirë në të hyrat e rregullta. Po gjatë kësaj

periudhe janë arkëtuar mbi 31.4 milionë euro të hyra për FKPK. Pra, gjithsej të hyra gjatë kësaj periudhe raportuese (tatimet, FKPK dhe nga të hyrat e njëhershme nga FKPK) janë në vlerë mbi 149 milionë euro", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Sipas këtij njoftimi, rezultatet pozitive për rritjen e të hyrave janë avancimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve. "Po ashtu, këtu rol të rëndësishëm ka edhe pjesa e legjislacionit tatimor, përmes së cilës bëhen përpjekje të vazhdueshme që të krijohet një infrastrukturë e mirë ligjore", është thënë në këtë njoftim.

Edhe Dogana e Kosovës ka vazhduar me performancë të mirë në aspektin e realizimit të të hyrave. Parashikimi vjetor i të hyrave në kufi sipas buxhetit për vitin 2018 është 1,175 milion euro. Dogana gjatë periudhës janar-mars 2018 ka arritur në total vlerën rreth 212 milionë euro. "Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2017, të hyrat doganore



shënuan rritje për 2 për qind apo 4.1 milionë euro më shumë. Gjatë kësaj periudhe ndikim te të hyrat nga importi kanë pasur politikat fiskale të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2018, që favorizojnë ulje taksash në kategori të caktuara, si stimulim i zhvillimit ekonomik. Për këtë tremujor vlera e mallit që është liruar nga taksat në import është 55 milionë euro dhe ndikimi në taksat ka qenë 12.6 milionë euro vetëm nga lirimet për lëndën e parë dhe inputet që përdoren në proces të prodhimit e që, krahasuar me tremujorin e vitit të kaluar, lirimet nga taksat në import kanë shënuar rritje prej

116-përqindësh", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, kategori tjetër që ka ndikuar në të hyra me pak është edhe MSA-ja, ku përgjatë kësaj periudhe (tremujori i parë) ndikimi nga MSA-ja është rreth 8.8 milionë euro apo rreth 41.6 për qind më shumë sesa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Gjithashtu, efekti i vendimit në kufizimin e veturave në import deri në 10 vjet ka ndikuar që të ketë rënie të importit të veturave të përdorura për 46 për qind. Efekti negativ në të hyra vetëm për këtë tremujor tek kategoria e importit të veturave të përdorura

është katër milionë euro", është thënë në njoftimin e Doganës.

Sa i përket eksportit, në sasi ka shënuar një rënie prej 15.63-përqindësh, ndërsa në vlerë shënon rritje prej 2.59-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. "Pavarësisht prej politikave fiskale, MSA-ja dhe vendimit për kufizimin e veturave që kanë ndikuar në të hyra, përsëri Dogana ka arritur të performojë mirë në mbledhjen e të hyrave për këtë tremujor", është theksuar në njoftimin e Doganës së Kosovës.

## Suedia e kënaqur me zhvillimet në Ministri të Financave

PRISHTINE, 5 PRILL - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Henrik Nilsson, me të cilin ka diskutuar për progresin dhe për sfidat e vendit tonë në fushën e financave dhe të ekonomisë. Në këtë takim është diskutuar edhe për progresin e arritur deri më tani për implementimin e projekteve, përmes të cilave shteti suedez i ndihmon Kosovës për zhvillimin e saj, si dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, në veçanti në fushën regjistrimit të pronave.

Ministri Hamza për të gjitha këto ka falënderuar ambasadorin suedez Henrik Nilsson për ndihmën dhe kontributin që shteti i tij ka dhënë dhe vazhdon të japë për institucionet e Kosovës. Ndërsa ambasadori i Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Henrik Nilsson, duke falënderuar ministrin Hamza



për pritjen dhe informimin me të gjitha zhvillimet, është shprehur shumë i lumtur për

progresin e arritur në Ministrinë e Financave. Sipas tij, falë këtij progresi dhe

bashkëpunimi të shikëlqyeshëm të të dy shteteve, në të ardhmen do të

shihet mundësia për thellimin e bashkëpunimit edhe në fusha të tjera.



# Konfiskohen armë dhe municion në Hajvali

PRISHTINË, 5 PRILL - Policia e Kosovës ka njoftuar se Njësia e Hetimeve të Përgjithshme e Rajonit të Prishtinës ka ndërmarrë një operacion bastisjeje në fshatin Hajvali, me ç'rast ka sekuestruar armë dhe municion. Gjatë bastisjes në dy lokacione të ndryshme në Hajvali, policia ka sekuestruar një armë automatike "AK 47", një pistoletë të tipit "Zoraki", një pistoletë të tipit "Beretta" dhe gjashtë fishekë të armës

automatike "AK 47". Armët e lartpërmendura janë gjetur tek i dyshuari me inicialët XH. B, 58-vjeçar, shtetas i Republikës së Kosovës. "Ky operacion i bastisjes ka ardhur si rezultat i një pune operative dhe hetimore që hetuesit policorë kanë bërë lidhur me identifikimin dhe kapjen e personave të inkriminuar në një rast të një natyre tjetër që po hetohet nga policia", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Konfiskohet rreth gjysmë toni mish i prishur në Ferizaj

FERIZAJ, 5 PRILL - Inspektorati Komunal në Ferizaj, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka konfiskuar rreth gjysmë toni mish dhe nënprodukte të llojit të mishit të prishura. "Pas ekzaminimit të produkteve inspektorët

përkatës kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për konfiskimin dhe asgjësimin e tyre dhe për procedimin e mëtutjeshëm në përputhje të rregullativës ligjore në fuqi. Aksioni për kontrollin e produkteve

ushqimore do të zhvillohet në vazhdimësi, në luftën e pakompromis me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve nga produktet që ofrohen në treg", është bërë me dije në njoftimin e Komunesë së Ferizajt.

# Komuna e Malishevës ndalon shtrimin e kubëzave jashtë kriterëve

MALISHEVË, 5 PRILL - Komuna e Malishevës ka ndërprerë shtrimin e kubëzave nga shkolla e Damanekut deri në Bubël për shkak se ky projekt nuk i ka plotësuar kriteret e parapara. "Gjatë inspektimit të punimeve është vërejtur se operatori nuk e ka respektuar kriterin e trashësisë së kubëzave. Sipas dokumentacionit të këtij projekti, trashësia e kubëzave duhet të jetë 8 cm, ndërsa kubëzat që kishin filluar të shtrohen ishin me trashësi prej 6 cm", është bërë me dije në njoftimin e Komunesë së Malishevës. Trotuari Damanek - Bubël ka një gjatësi prej 1 mijë e 450 metrash dhe ndërtimi i këtij trotuari është bërë me



qëllim të lehtësimit të udhëtimit dhe sigurisë së nxënësve nga

fshati Bubël të cilët shkojnë në shkollën e Damanekut.

# Mantelbardhët u bashkohen aksioneve ekologjike në Prizren

PRIZREN, 5 PRILL - Kryetari i Komunesë së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka bërë me dije se janë duke vazhduar aksionet ekologjike në këtë komunë. Ai ka thënë se këtyre aksioneve u janë bashkangjitur edhe mantelbardhët e Prizrenit. "Aksionet e javës ekologjike po vazhdojnë. Aktivitetit

'Pastro përtej pragut' i janë bashkëngjitur edhe 44 qendra kryesore të mjekësisë familjare në Prizren. I falënderojmë mantelbardhët dhe drejtoreshën Flaka Siqeca për iniciativën. Ftojme të gjithë qytetarët të na bashkëngjiten dhe të pastrojnë përtej pragut të tyre", ka thënë Haskuka.



# Komuna e Ferizajt përkrah financiarisht festivalin "Fëmijët e gëzuar"

FERIZAJ, 5 PRILL - Zotimi i kryetarit të Komunesë së Ferizajt, Agim Aliu, për mbështetjen e festivaleve tradicionale dhe emblematike të Ferizajt, është duke gjetur zbatim në praktikë. Aliu të enjten ka pritur në takim drejtuesit e Festivalit "Fëmijët e gëzuar" që

në këtë vit mbush 30 vjet të funksionimit. Gjatë këtij takimi është diskutuar për mbarrëvajtjen e këtij festivali dhe për përgatitjet që po bëhen për shënimin e 30-vjetorit të funksionimit të tij. Kryetari i Komunesë së Ferizajt, Agim Aliu, ka ndarë një fond

për mbulimin e shpenzimeve dhe organizimin e Festivalit "Fëmijët e gëzuar". Drejtori i këtij festivali, Nazmi Aliu, është shprehur falënderues ndaj qeverisjes lokale të udhëhequr nga kryetari Aliu për mbështetjen që po ia jep artit dhe kulturës në përgjithësi.





## Mbahet në Gjakovë sesioni informues për platformën e hartimit të biznes-planeve

**GJAKOVË, 5 PRILL** - Në kuadër të projektit "Idea to Success" të organizuar nga "Jakova Innovation Center", përkrahur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është mbajtur të enjten sesioni informues për platformën e hartimit të biznes-planeve. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, i cili ka thënë se kjo platformë do të jetë një ndihmesë e madhe për bizneset. "Biznesi është gjithmonë i lidhur me inovacionin dhe kombinimi i tyre na sjellë industri të mëdha", ka thënë ai. Prezantimin e platformës e ka realizuar menaxheri i këtij projekti "Idea to Success" i cili ka treguar për funksionimin e saj dhe për qasjen që do të kenë qytetarët për realizimin e biznes-planeve.




## Nisin punimet për riasfaltimin e rrugës në fshatin Beleg

**DEÇAN, 5 PRILL** - Rruga në brendi të fshatit Beleg të Komunës së Deçanit, e cila ishte dëmtuar gjatë rregullimit të kanalizimit të ujërave të zeza, tashmë është duke u rregulluar. Kjo rrugë në brendi të fshatit Beleg lidhë mbi tetë fshatra të Komunës së Deçanit. "Ne si institucion duhet të jemi të kujdesshëm karshi kërkesave të qytetarëve të Komunës së Deçanit", ka thënë kryetari i komunës, Bashkim Ramosaj, duke shtuar se, pas përfundimit të kanalizimit të ujërave të zeza në këtë fshat tashmë dhe rregullimit të riasfaltimit të mbi 1 300 metrave rrugë, do të lehtësohet sadopak qarkullimi i banorëve të këtij lokaliteti, por edhe të atyre që frekuentojnë këtë rrugë. Po ashtu, Ramosaj ka bërë inspektimin e punimeve të disa rrugëve në fshatin Glllogjan.



## Fshati Pozheran bëhet me E-Kioskë për nxjerrjen e dokumenteve

**Viti, 5 prill** - Nga dita e enjte banorët e fshatit Pozheran të Komunës së Vitisë mund të pajisjen me dokumente kadastrale dhe të gjendjes civile në E-Kioskun që është vendosur në qendër të fshatit. Certifikatat e pronës mund të tërhiqen vetëm nga banorët e Vitisë, kurse dokumentet e gjendjes civile mund të tërhiqen nga të gjithë shtetasit e Kosovës me letërnjoftim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ky shërbim elektronik, i cili është në dispozicion për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, është financuar nga USAD-i amerikan në kuadër të Programit për të Drejtat Pronësore dhe dokumentet mund të tërhiqen nga aty në çdo kohë.



## Hapet rruga alternative paralel me rrugën e bllokuar në Shalën e Bajgorës

**MITROVICË, 5 PRILL** - Zyrtarë komunalë nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, së bashku me gjeologët nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, kanë qëndruar në fshatin Trepçë ku, për shkak të rrëshqitjeve të dheut, është bllokuar rruga. Zyrtari i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Blerim Mehulli, ka bërë me dije se në vendin ku ka pasur rrëshqitje të dheut dhe bllokim të rrugës, ishin për vizitë edhe tre gjeologë të Shërbimit Gjeologjik i Kosovës. Po ashtu, ai ka shtuar se rruga kryesore nga data 16 mars është e mbyllur me urdhër të Ministrisë së Infrastrukturës. Mehulli ka thënë se është përgatitur për qarkullim rruga alternative që do të përdoret derisa të gjendet një zgjidhje afatgjatë kundër rrëshqitjes së dheut në këtë pjesë. Ekipi i gjeologëve që ka analizuar gjendjen në këtë zonë ka konstatuar se hapi i Ministrisë së Infrastrukturës për mbylljen e kësaj rruge ka qenë shumë i qëlluar pasi ajo vazhdon të jetë problem për sigurinë e qytetarëve që frekuentojnë në baza ditore këtë rrugë.

## Sot në Gjilan fillon aktiviteti "Ditët e Kuvendit"

**GJILAN, 5 PRILL** - Kuvendi i Republikës së Kosovës, me iniciativën e Forumit për Transparencë Parlamentare, organizon Ditët e Kuvendit

2018. Gjatë takimeve publike që do të zhvillohen në qytetet e Kosovës, qytetarët do ta kenë mundësinë të diskutojnë drejtpërdrejt me

deputetët. Takimi i parë publik do të organizohet sot (e premte) në Gjilan, në Teatrin e Qytetit, me fillim nga ora 14:00. Nga Kuvendi i

Kosovës do të marrin pjesë deputetët: Zenun Pajaziti, Lirije Kajtazi, Ismajl Kurteshi, Besa Baftiu, Ahmet Isufi dhe Milaim Zeka.





## Putini kërkon të zbusë çështjen "Skripal"

**MOSKË, 5 PRILL** - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se shpreson që "arsyeja e shëndoshë" do të mbizotërojë në mosmarrëveshjet me Londrën, rreth helmimit të ish-spiunit rus,

Sergei Skripal, dhe vajzës së tij, Yulia. Të dy ata janë helmuar me agjent nervor në qytetin Sallsbëri të Anglisë, më 4 mars. Britania thotë se Rusia, pothuajse

me siguri, duhet fajësuar për sulmin kundër Skripalit, por Moskë e mohon përfshirjen. Incidenti ka shkaktuar krizë diplomatike - shtetet perëndimore dhe Rusia i kanë dëbuar

njëra-tjetër dhjetëra diplomatë. "Presim momentin kur do të mbizotërojë arsyeja e shëndoshë dhe kur marrëdhëniet ndërkombëtare nuk do të dëmtohen si tani", tha Putini.



# Një aleancë kontradiktore vendos për të ardhmen e Sirisë

Bisedimet midis presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan, atij rus, Vladimir Putin, dhe homologut të tyre iranian, Hassan Rohani, kanë qenë të parat në pesë muaj të nivelit të tillë për të ardhmen e Sirisë

**ANKARA, 5 PRILL** - Presidentët e Iranit, Turqisë dhe Rusisë kanë shprehur vendosmërinë e tyre "për të përsheptuar përpjekjet në sigurimin e paqes në Siri". Pas takimit në Ankara, ata kanë thënë se janë të përkushtuar për arritjen e "armëpushimit të qëndrueshëm" atje.

Bisedimet midis presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan, atij rus, Vladimir Putin, dhe homologut të tyre iranian, Hassan Rohani, kanë qenë të parat në pesë muaj të nivelit të tillë për të ardhmen e Sirisë.

Shtetet e Bashkuara nuk kanë qenë atje, por problemi është se Rusia, Turqia dhe Irani kanë treguar prioritetet kundërthënëse dhe interesa të ndryshëm, si për Sirinë, ashtu edhe për gjithë rajonin.

Teherani, për kohë të gjatë, ka mbështetur regjimin e presidentit sirian, Bashar al-Assad, ndërsa është edhe armik i aleates së NATO-s, Turqisë. Moskë e ka mbështetur Iranin ekonomikisht, ndërsa Siria është aleati i saj më i afërt në Lindjen e Mesme. Ankaraja e kundërshton Assadin dhe është përplasur me Rusinë për shekuj me radhë.

"Që nga fillimi, kjo aleancë trepalëshe midis Moskës, Ankarasë dhe Teheranit është aleancë e komoditetit. Është



shumë e pazakontë për shkak të interesave të ndryshëm që kanë", thotë Marc Pierini, ish-ambasador i Bashkimit Evropian në Turqi, Siri, Libi dhe Tunizi. Pastaj vjen Uashingtoni - për kohë të gjatë forcë dominuese në politikën e Lindjes së Mesme - me të cilin të tri shtetet kanë agjenda konfliktuale, ndonëse kanë nevojë për të, për të balancuar disa forca.

Në rastin e Izraelit, për shembull, ShBA-ja ndihmon që ta parandalojë atë në ndërmarrjen e veprimeve më agresive kundër forcave të Qeverisë siriane apo milicive të Iranit. Uashingtonit po ashtu do t'i duhet për të ndihmuar në organizimin dhe financimin e rindërtimit të Sirisë, kur të përfundojë konflikti.

Takimi i parafundit midis Putinit, Rohanit dhe Erdoganit është zhvilluar nëntorin e kaluar në qytetin Soçi të Rusisë. I emërtuar Procesi i Astanës - sipas kryeqytetit të Kazakistanit,

ku tre vendet kanë nisur fillimisht përpjekjet e përbashkëta - ai takim nuk ka sjellë rezultate. Në muajt që kanë pasuar, ka pasur veprime të shtuara ushtarake në Siri nga të tri palët.

Siria, ndërkohë, ka kryer sulme me armë kimike kundër forcave opozitare në zonat civile.

"Askush në Perëndim nuk beson se Procesi i Astanës do të sjellë rezultat të qëndrueshëm. Procesi duhet të kthehet në tryezat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Për të pasur diskutime të frytshme, duhet edhe pozicioni i ShBA-së, e cila nuk është atje", thotë Pierini, i cili tani është analist në Institutin Carnegie Europe.

Sipas tij, veprimet e Turqisë dhe lidhjet e saj të ngrohta me Moskën duket se janë motivuar pjesërisht nga politikën e brendshme dhe politikanët nacionalistë që i konsiderojnë kurdët kërcënim për shtetin turk. Pierini thotë se rrezik real për

Perëndimin është se Irani dhe Rusia mund t'i japin Turqisë dritën e gjelbër për të zgjeruar operacionet e saj në lindje të Sirisë, ku ShBA-ja ka rreth 2,000 forca që operojnë së bashku me njësitet britanike dhe franceze, si dhe me milicite kurde.

"Një gjë e tillë do të ishte jashtëzakonisht e komplikuar", thotë Pierini.

Kur bëhet fjalë për Rusinë, veprimet e saj në Siri kanë qenë prej kohësh pjesë e një strategjie, qëllim i së cilës është të sfidojë ShBA-në në kriza të mëdha gjeopolitike, thotë analistja ruse, Olga Olikier. Por, kjo paraqet rrezik për Moskën.

"Qasja e Rusisë duket të jetë kjo: ngrihu kundër ShBA-së, të themi në Siri, arrij marrëveshje dhe pastaj kjo është përgjegjësi e ndarë", thotë Olikier. Megjithatë, sipas saj, Rusia tani përballet me tjetër model.

"Rusisë i ka mbetur të gjejë fundin e lojës me ShBA-në, që

deri në një masë të caktuar, luan rolin e ndërhyrës. Ky është ndryshim i roleve", thotë Olikier. Steven Cook, ekspert në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë në Uashington, thotë se takimi në Ankara është një përkujtes për suksesin e Rusisë në mbushjen e vakuimit që ka lënë mosangazhimi i ShBA-së në rajon.

"Në Siri, rusët kanë demonstruar vullnet politik dhe mbajtje të fuqisë", ka shkruar Cook në një analizë këtë javë.

"Rusët nuk po largohen, ata kanë një strategji për të dobësuar Perëndimin dhe kjo fillon në Lindjen e Mesme. Për më tepër, Moskë nuk e ka më bagazhin ideologjik të komunizmit, duke e bërë më të lehtë për të që të bëjë avancime në rajon", ka shkruar Cook.

Lufta civile në Siri ka nisur qysh në vitin 2011. Mbi 360,000 njerëz janë vrarë dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë.

## Diplomatët e dëbuar amerikanë largohen nga Moskë

**MOSKË, 5 PRILL** - Dhjetëra diplomatë amerikanë dhe familjet e tyre u larguan nga Ambasada e Uashingtonit në Moskë të enjten.

Tre autobusë u panë të largoheshin nga kompleksi i Ambasadës amerikane në drejtim të aeroportit. E enjta ishte afati i fundit i caktuar nga Moskë për largimin e diplomatëve.

Një stuhë dëbimesh diplo-

matike pasoi helmimin më 4 mars të Sergei Skripalit dhe vajzës së tij, akt për cilin Britania thotë se u krye me një agjent nervor ushtarak të zhvilluar nga ish-Bashkimi Sovjetik.

Ish-agjenti i dyfishtë, i cili dezertoj në Britani, dhe vajza e tij Yulia u gjetën pa ndjenja në një park në qytetin Salisbury. Londra tha se ka "gjasa të shumta" që Moskë ishte pas

përpjekjeve për vrasjet, një akuzë që Kremli e mohon.

Ngjarja shkaktoi tendosje të ndjeshme të marrëdhënieve mes Rusisë dhe Perëndimit. Më shumë se 150 diplomatë rusë u dëbuan nga ShBA-ja, vendet e Bashkimit Evropian dhe ato në NATO si dhe vende të tjera si ndëshkim ndaj Kremilit. Rusia u kundërpërgjigj me të njëjtat masa dëbimi.





# Gashi: Teatri dhe biblioteka nuk do t'i kenë më problemet e deritashme

Pas inspektimit, në ambientet e Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe të Bibliotekës Kombëtare, Gashi është shprehur se gjendja e tyre është shumë e keqe, prandaj ka premtuar se shumë shpejt ministria do t'i ndërmarrë të gjitha hapat, në koordinim edhe me institucionet dhe organet kompetente, për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë për këto dy institucione të kulturës.

**PRISHTINË, 5 PRILL (ER)** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar të enjten ambientet e Teatrit Kombëtar të Kosovës dhe të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ministri Gashi ka parë gjendjen në të cilën ndodhen objektet dhe dëmet që janë shkaktuar nga ujërat e zeza në hapësirat e nëndheshme të tyre. Pas inspektimit, Gashi është shprehur se gjendja e tyre është

shumë e keqe, prandaj ka premtuar se shumë shpejt ministria do t'i ndërmarrë të gjitha hapat, në koordinim edhe me institucionet dhe organet kompetente, për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë për këto dy institucione të kulturës. "Në objektin e Teatrit Kombëtar isha të shoh çfarë ka ndodhur aty pas vërshimeve të ujit në ditët e fundit dhe pas dëmtimit të kanalizimit. U bëj thirrje



institucioneve dhe kompanisë së ujësjellësit ta marrin sa më seriozisht këtë punë. Aty është edhe ora e rrymës dhe ka mundësi të krijohet problem më i madh", është shprehur ministri Gashi. Edhe në vizitën që ka realizuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ministri Gashi ka theksuar se në qershor do të bëjnë një plan konkret për ta zgjidhur problemin e ujërave të zeza, të kanalizimit dhe të evitimit të lagështisë në hapësirat ku janë të ruajtur fondet e bibliotekës. "Nga dimri që vjen biblioteka nuk do ta ketë më problemin e kanalizimit dhe të lagështisë", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se kanë biseduar edhe për intervenimet që do

t'i bëjnë gjatë vitit 2018. "Ky objekt nuk ka as kanalizim e nuk ka as mbrojtje nga lagështia. Ne po punojmë për rishikimin e buxhetit dhe jemi duke shikuar për të investuar për ruajtjen e të gjithë ekzemplarëve të bibliotekës", ka thënë ministri Gashi, duke shprehur përkushtimin e ministrisë për investim në Bibliotekën Kombëtare. Po ashtu, ministri Gashi ka folur edhe për zgjidhjen e çështjes së vendosjes së përhershme në objektin e Baletit të Kosovës. "Ju e dini se jemi në fazën fillestare të ndërtimit të një objekti të ri të operës. Pjesë e tij do të jetë edhe baleti", ka thënë ministri Gashi në një intervistë për media.

## Komuna e Mitrovicës merr përkrahjen e MKRS-së

**MITROVICË, 5 PRILL (ER)** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, me të cilin ka biseduar për projekte të ndryshme në fushën e kulturës, të trashëgimisë kulturore dhe të sportit. Ministri Gashi ka treguar gatish-

mërinë për ta ndihmuar këtë komunë për realizim të projekteve. Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e ka informuar ministrin për punët që janë realizuar në Komunën e Mitrovicës gjatë vitit të kaluar dhe për planet dhe projektet që kanë për këtë vit në fushën e trashëgimisë kulturore, kulturës

dhe sportit.

Ai e ka falënderuar ministrin për mbështetjen që i ka dhënë kësaj komune që t'i përkrahë projektet në fushat që mbulon MKRS-ja duke shprehur në thellim e mëtutjeshëm të bashkëpunimit me synimin që të avancohen fushat e kulturës e të sportit në këtë komunë.



## Beqiraj boton poezi në revistën "The Year of the Poet V"

**PRISHTINË, 5 PRILL** - Poetesa nga Kosova, Naime Beqiraj, ka botuar në revistën e njohur "The Year of the Poet V", të korporatës botuese "Inner Child Press International LTD", me seli në Nju Jersey të ShBA-së, një cikël poetik të zgjedhur, përkthyer në gjuhën angleze nga poeti dhe përkthyesi Fahrerdin Shehu. Beqiraj në këtë revistë është prezantuar në edicionin e

muajit prill.

Kjo revistë ka pasur cikle të botimeve ku është prezantuar bota mineralogjike, bota bimore, bota shtazore, ndërsa tani edhe me ciklin e kulturave botërore që shënon numrin e parë të këtij cikli ku poezia shqipe përfaqësohet nga poetesha Naime Beqiraj.

Krahas autores nga Kosova, në këtë edicion janë prezantuar

edhe autorë të njohur të poezisë që krijohet sot në botë. Si redaktor kulturor pranë kësaj shtëpie botuese, poeti Fahredin Shehu ka marrë për detyrë të promovojë vlera të poezisë bashkëkohore shqipe në kuadër të kësaj shtëpie botuese. Së shpejti pritet që poezia e Naime Beqiraj, e përkthyer po ashtu nga Shehu, do të botohet edhe në një antologji poetike në Mauritanë.





**E jashtëzakonshme**

## Gjen miun në shishen e 'Coca-Cola'-s

Një person në Argjentinë ka treguar se ka gjetur një mi të ngordhur që lundronte në shishen e "Coca-Cola"-s. Diego Pereya e ka postuar videon në rrjetet sociale ku shihet miu në shishen e mbyllur të "Coca-Cola"-s. Ai ka thënë se ka zbuluar diçka të pazakontë në shishe dhe ka vendosur ta filmojë.



**FOTO E DITES**




Një punonjës shihet duke pastruar shkallët në Muzeun Kombëtar të Koresë në Seul. /AP/

**E rrallë**

## Zbulohen gjurmët e dinozaurëve më të mëdhenj në botë

Shkencëtarët kanë zbuluar gjurmët e këmbëve që kanë lënë pas dinozaurët më të mëdhenj në botë në Isle of Skye, Britani. Gjurmët janë lënë nga dinozaurët 170 milionë vjet më parë, por vetëm kohët e fundit janë parë në shkëmbinjtë e Skye. Sauropodët ishin të gjatë 15 metra dhe peshonin më shumë se 10 tonë.



## BARSOLETA E DITËS



**Burri dhe gruaja:**

- I krahasova shpenzimet e dasmës sonë me vlerën e çejzit tënd.
- Dhe...?
- Llogaria po më del se me ty qenkam martuar për dashuri.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

## "BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

## "PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

## "PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

## "RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenaerts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.



**DASHI**  
Është mirë të mos flisni shumë për idetë tuaja me personat që sapo i keni njohur. Sepse mund t'i përvetësojnë.



**DEMI**  
Sot ju duhet të jepni prova për altruizmin tuaj, sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni për zemër.



**BINJAKËT**  
Keni kohë që jeni bërë viktima të konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë, do të keni një ditë të mirë.



**GAFORRJA**  
Është një çështje që ju shqetëson prej kohësh dhe tani ka ardhur momenti t'i jepni fund. Gjithçka do të shkojë si duhet.



**LUANI**  
Ka projekte që ju kanë marrë shumë kohë dhe do ta kuptoni se nuk mund t'i realizoni. Mbani distancë përpara se të jetë vonë.



**VI RGJËR ESHA**  
Kontaktet që keni krijuar gjatë karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh.



**PESHORJA**  
Nëse nuk doni ta humbni mbështetjen e personave pranë jush, duhet të jeni më të pranishëm në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



**AKREPI**  
Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin vend pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbylleni në vetvetë.



**SHIGJETARI**  
Keni zgjedhur mënyrën më të mirë për të qenë të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm dhe kjo ju ka ndihmuar.



**BRICJAPI**  
Kohët e fundit keni qenë mjaft të zënë me jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Kjo mund të krijojë ngecje në karrierë.



**UJORI**  
Sot mund të merrni vendime shumë të ndryshme nga sa keni thënë më parë, sepse në çdo moment do të keni ndryshime të situatave.



**PESHQIT**  
Keni guxuar më shumë sesa që duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet t'i merrni mbi vete të gjitha





**QENDRA SPORTIVE**  
 "BUJQËSIA"  
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	HANNOVER 96 - WERDER BREMEN <b>2</b>	CHATEAUROUX - AC AJACCIO <b>1</b>	CARDIFF - WOLVERHAMPTON <b>GG</b>
-------------------	--------------------------------------	-----------------------------------	-----------------------------------

# Rexha: Debatimi për trajnerët nga Shqipëria, i panevojshëm



Kastriot Rexha e ka vlerësuar të panevojshëm debatin për trajnerët nga Shqipëria që janë të angazhuar në futbollin e Kosovës. "Është një debat shumë i panevojshëm, pasi të gjithë ne jemi të një gjaku dhe ardhja e trajnerëve nga Shqipëria në futbollin e Kosovës vetëm sa e ka begatuar dhe e ka bërë më interesante Superligën. Nuk i kontribuojmë futbollit me debate të tilla, por të gjithë duhet ta ulim kokën dhe të punojmë më shumë", ka thënë Rexha për "Epokën e re"

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINE, 5 PRILL** - Trajneri i skuadrës së Llapit, Tahir Batatina, ishte i pari që e filloi debatin lidhur me trajnerët nga Shqipëria që punojnë në Kosovë. Strategu llapjan kishte paralajmëruar se ata shumë shpejt do të rikthehen përmes autostradës dhe trajnerët në Kosovë do të kenë mundësi më të madhe për t'u angazhuar në klubet elitare. I fundit që ka folur për këtë debat është futbollisti Kastriot Rexha, i cili ka bërë karrierë edhe në futbollin e Shqipërisë. Ai e ka quajtur debat të padobishëm për futbollin e Kosovës pasi, sipas tij, ardhja e trajnerëve nga Shqipëria e ka pasuruar Superligën. "Është debat shumë i panevojshëm, pasi të gjithë ne jemi të një gjaku dhe ardhja e trajnerëve nga Shqipëria në futbollin e Kosovës vetëm sa e ka begatuar dhe e ka bërë më interesante Superligën. Nuk i kontribuojmë futbollit me debate të tilla, por të gjithë duhet ta ulim kokën dhe të punojmë më shumë", ka thënë Rexha për "Epokën e re".

Në këtë edicion në elitë shumë skuadra po luftojnë për titull të kampiones, kurse e para në tabelë është Drita e drejtuar nga Bekim Isufi. Më pas renditen Prishtina e Mirel Joses, Liria e Blendi

Shkëmbit dhe Feronikeli i Sulejman Starovës. Sulmuesi Kastriot Rexha, i cili është pjesë e Dritës, ka shprehur besim të plotë se në fund triumfues do të dalë trajneri i tij, Bekim Isufi. "Ne po e udhëheqim garën për titull. Cilësia e skuadrës më bënë optimist të them se trajneri ynë, Bekim Isufi, do të triumfojë në këtë garë me trajnerët nga Shqipëria", ka shtuar Rexha, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e skuadrës së Vllaznisë nga Shkodra.

Ndeshjen e radhës Drita e Gjilanit e zhvillon ndaj Besës së Pejës, kurse kjo ndeshje është e veçantë

për sulmuesin prishtinas. "Ndeshja e radhës ka domethënie për mua se kam luajtur tre vjet për skuadrën e Besës dhe kam kaluar shumë mirë duke regjistruar edhe rezultate si triumfi në Kupën e Kosovës. Mirëpo tash tri pikët ndaj Besës janë jetike për skuadrën tonë, pasi na japin mundësinë ta mbajmë diferencën me Prishtinën në tri pikë", ka shtuar Rexha, i cili hapat e parë në futbollin profesionist i mori te skuadra e 2 Korrikut, kurse më pas ka luajtur edhe për Hysin, KEK-un, Trepçën '89, Prishtinën dhe besën.

## Vllaznia - Liria hapë javën e 26

Ndeshja në mes të Vllaznisë nga Pozharani dhe Lirisë së Prizrenit e hapë javën e 26 në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e Lirisë është favorite në këtë ndeshje për faktin se po lufton për titull, por vendësit e Vllaznisë do t'i kërkojnë tri pikët për t'i mbajtur gjallë shpresat që të luajnë në barazh. Ndërsa derbi i kësaj xhiro zhvillohet të shtunën në mes të Feronikelit dhe Trepçës '89, kurse po të njëjtën ditë luajnë edhe Besa e Drita. Dy ndeshje zhvillohen të dielën, kurse ndeshja e fundit zhvillohet të hënën në mes dy skuadrave nga kryeqyteti: Flamurtari-Prishtina.

## VALA SUPERLIGA

**Të premten takohen:**  
**Vllaznia - Liria**

**Të shtunën takohen:**  
**Feronikeli - Trepça'89**  
**Besa - Drita**

**Të dielën takohen:**  
**Vëllaznimi - Drenica**  
**Llapi - Gjilani**

**Të hënën takohen:**  
**Flamurtari - Prishtina**

## SHKURT

### Ligji për sponsorizim do ta rrisë fuqinë financiare të klubeve

Ligji për sponsorizim do të mundësojë që klubet të gjenerojnë të hyra më shumë, të gjejnë sponsorë më shumë dhe ta rrisin fuqinë e tyre financiare, në mënyrë që këta të fundit të zgjerohen me kapacitete. Kështu është thënë sot në Mitrovicë, gjatë takimit të përfaqësuesve të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) me përfaqësues komunalë, të klubeve sportive dhe bizneseve të Komunës së Mitrovicës, ku është diskutuar mbi Rregulloren dhe Ligjin për Sponsorizim

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, tha se Ligji për sponsorizim ka qenë i mirëpritur, sidomos nga komuniteti sportiv. Besim Hasani, kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës, potencoi se është i vetëdijshëm për kontributin e secilit në kushtet e vështira të kohës gjatë së kaluarës, por tha se duhet të jenë mirënjohës të gjithë për mbështetjen e fuqishme që tani po japin institucionet shtetërore në këtë drejtim. Ai tha se beson në pjekurinë e përfaqësuesve të sportit dhe të biznesit, se këtë ligj do ta shfrytëzojnë për të mirën e sportistëve, klubeve, federatave dhe ngjashëm.

Ndërsa sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhija, tha se sporti në Kosovë gradualisht po ngrihet në nivelin e politikës nacionale shtetërore. Sipas tij, shumica e shteteve të rajonit nuk i kanë këto ligje kaq të favorshme sikurse shteti i Kosovës. Haxhija ka kërkuar nga sportistët që këtë mbështetje kaq të madhe nga ana e institucioneve, ta shndërrojnë dhe ta kthejnë në rezultate sa më të mira.

### Avdijaj: Kam refuzuar klube të mëdha për Schalken

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Donis Avdijaj, ka bërë me dije se është kërkuar nga shumë skuadra të mëdha evropiane, por që kishte vendosur të qëndronte te Schalke 04. 21-vjeçari aktualisht është i huazuar te klubi holandez Roda JC, por është i penduar që e kishte refuzuar Real Madridin për Schalken. "Kur isha 18-vjeçar mund të shkoja në klube si Real Madridi, Juventus, Manchester Unitedi, Manchester City dhe Liverpools, por zgjedha të qëndroja me Schalken", ka thënë Avdijaj.

### Milani "blindon" Gattuson

Pritja merr fund dhe tashmë Genaro Gattuso konfirmohet në stolin e Milanit edhe për tre sezonet e ardhshme. Pas shumë zërash mbi rinovimin, tekniku e ka firmosur të enjten kontratën e re me kuqezinjët, që do t'i mbajë të lidhura palët deri në vitin 2021. Ky është një shpërblim për punën e mirë të Gattusos, që ka arritur t'i bindë drejtuesit e klubit në pak më tepër se katër muaj, se ai është i aftë për ta drejtuar projektin e Milanit. "Nuk na u desh shumë të negocionim me Gattuson. I treguam projektin tonë, që mbetet shumë ambicioz dhe menjëherë ramë dakord që ai është njeriu i duhur për ta drejtuar skuadrën në tre vjetet e ardhshme", u shpreh drejtori sportiv i Milanit, Marco Fassone.

### Alonso: McLaren, pretendenti për podiumin

Fernando Alonso ka besim se makina McLaren mund të luftojë për tre vendet e para në Çmimin e Madh të Bahreinit, garë që do të zhvillohet këtë fundjavë. Në konferencën për shtyp përpara garës, piloti spanjoll deklaroi se "makina ka potencial". "Në Australi kapëm një vend të pestë, por të mos harrojmë se të dyja makinat Haas e Braktisën garën dhe pati një dalje të makinës së sigurisë. Nëse i marrim maksimumin makinës që kemi, mund të luftojmë me më të mirët", theksoi dy herë kampioni i botës. "Mendoj se me të parët (Mercedes dhe Ferrari) kemi hendek të madh, por në pesë garat e ardhshme do të përpiqemi ta zvogëlojmë këtë hendek. Nuk pres të luftoj për titullin, por në disa gara besoj se do të luftoj për podiumin, ndërsa pres që të përfundoj shpesh në vend të pestë e të gjashtë", ka deklaruar Alonso.



## Neueri rikthehet në stërvitje pas gjashtë muajsh

**MUNICHEN, 5 PRILL** - Shpresë për Manuel Neuerin për të qenë pjesë e Gjermanisë në "Rusi 2018". Klubi "bavarez" ka njoftuar se për herë të parë pas gjashtë muajsh 32-vjeçari ka nisur të stërvitet me topin, çfarë bën të mendosh se nuk do ta

humbasë Botërorin. Neueri ka bërë ushtrime të ndryshme, duke e goditur pa problem topin me këmbë. "Gardiani" i kampionëve të Bundesligës mungon në fushat e blerta që nga muaji shtator, kur iu nënshtrua një ndërhyrje

kirurgjikale për të rikuperuar një frakturë në shpinën e këmbës. Fillimisht u mendua se portieri do të ishte në dispozicion të trajnerit Jupp Heynckes në fillim të vitit, por rikuperimi i plotë kërkoi më shumë kohë, aq sa shkaktoi frikë se mund ta

rrezikonte pjesëmarrjen në "Rusi 2018". Neueri ka më shumë se dy muaj kohë për ta rifituar gjendjen fizike dhe reflekset para se të nisë Botërorin. Pritet që të aktivizohet në radhët e Bayernit në disa takime të Bundesligës.



## Kahn, Bayernit: Merreni Zidanen për Ligën e Kampionëve

**MUNICHEN, 5 PRILL** - Ecuria e Real Madridit në Ligën e Kampionëve është diçka e paramenduar, sidomos në periudhën kur francezi mori drejtimin e madrilenëve. Mirëpo, dy Liga të Kampionëve të fituara radhazi me skuadrën spanjolle, filozofia e lojës dhe dominimi së fundmi në Evropë, e listojnë trajnerin aktual të galaktikëve si një ndër më të lakuarit momentalisht.

Oliver Kahn, duke komentuar përballjen e Realit, sidomos performancën e Zidanës në krye, i ka sugjeruar Bayernit t'i kthejë sytë nga ai për bankinën, në fund të sezonit. "Pa dyshim se ia vlen ta konsiderojmë Zidanen trajner të ardhshëm të Bayernit. Mendoj se do të ishte magjike", ka thënë Kahn për "ZDF". Më tej, ai ka komentuar situatën aktuale të trajnerit francez: "Është francez, flet spanjisht, por nuk do të thotë se nuk mund të mësojë gjermanisht".

Ish-gardiani legjendar i Bayernit dhe Gjermanisë ka bërë edhe krahasimin mes Kovaçit, një ndër pretendentëve




kryesorë për t'i pasur Heynckesin dhe Zidanen. "E kuptoj situatën aktuale të Bayernit, që ka dëshirë t'ia besojë ekipin dikujt që e njeh, e për këtë Kovaç është interesant, por ai nuk është ekspert për të bërë atë që Reali dhe Zidane kanë arritur në Ligën e Kampionëve", përfundon legjenda gjermane e portës, Oliver Kahn, në lidhje me pasuesin e trajnerit aktual të Heynckes.

Ky i fundit ka deklaruar se nuk mund të vijojë edhe një vit më tej me "bavarezët" dhe do të duhet të heqë dorë në fund të sezonit. Kovaç pritet ta zëvendësojë gjermanin në fund të sezonit, edhe pse asgjë nuk është zyrtare. Pochettino i Tottenhamit është një emër tjetër për stolin "bavarez". Rumenige deklaroi para një jave se trajneri i ri do të vendoset në fund të muajit prill.

## Toronto fiton ndaj Bostonit

**TORONTO, 5 PRILL** - Skuadra kanadeze e Torontos ka konsoliduar pozitën e saj në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores 96-78 ndaj Bostonit, përballja mes dy ekipeve më të mira në këtë kah të NBA-së. Një lojë e dobët e ekipit të Celticsit, ku Morrisi realizoi 21 pikë, të pamjaftueshme për ta evituar humbjen, ndërsa për Toronton u dalluan lojtarët e stolit, që realizuan 44 pikë, duke ia dhënë fitoren ekipit kanadez. Pas kohës shtesë fiton ekipi i Lakersit, që mundi 122-112 San Antonion, ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund. Kuzma me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për Lakersin, ndërsa për Spursin u dalluan Aldridge me 28 pikë e Murray me 23, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe ekipi i Philadelphia's që mundi 115-108 Detroitin në fushën e këtij të fundit, ndeshje e dominuar nga skuadra



mike, që konsolidon pozitën në vendin e katërt në Lindje. Më i miri në fushë ishte Reddicku me 25 pikë. Miami, falë 69 pikëve të realizuara nga lojtarët e stolit, mundi 115-86 Atlantën jashtë fushës dhe siguron një vend në "play-off" në Lindje.

REZULTATET	
Detroit - Philadelphia	108-115
Orlando - Dallas	105-100
Atlanta - Miami	86-115
New Orleans - Memphis	123-95
Toronto - Boston	96-78
Lakers - San Antonio	122-112

## Barça, favoritja kryesore për ta fituar Ligën e Kampionëve

Edhe pse ende nuk dihet se kush do të jenë katër gjysmëfinalistët e Ligës së Kampionëve për këtë sezon, rezultatet e thella të arritura nga disa prej ekipeve në ndeshjet e para, i kanë bërë kompanitë e basteve t'i ndryshojnë ndjeshëm kuotat për fitimin e këtij competi-

cioni. Sipas "Bet 365", pretendentët kryesorë janë katalunasit e Barcelonës. Fitimi i kompeticionit nga spanjollët kuotohet me 3.25. Pas tyre vjen një tjetër ekip spanjoll, Reali i Madridit, që kuotohet me 3.40, pastaj Bayerni me 4 dhe më pas Liverpooli (6.50),

City (17), Sevilla (151), Roma (201) dhen në fund, Juventusit me 251. E njëjta gjë edhe për kompaninë "888sport", ndërsa "Betfair" i sheh të barabarta shanset e Realit dhe Barcelonës për ta fituar trofeun. Secila prej tyre kuotohet me 3.25.

### SHKURT

#### Kloppi: Ende nuk jemi kualifikuar në gjysmëfinale

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se edhe përkundër fitores 3-0, ende skuadra e tij nuk është e kualifikuar në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. "Ne mundëm ekipin më të mirë në botë. Kjo ishte një performancë e jashtëzakonshme. Unë nuk kam qenë kurrë pjesë e ekipit më të mirë në botë, por gjithnjë e kam ditur se është e mundur t'i mundim ata. Me të gjitha gjërat që mund të them tani, nuk dua t'i bëj edhe më të zemëruar 'qytetarët'. Ne duhet të punojmë atje, përsëri, sepse na pret 'ferri'. Ka ende punë për të shkuar në raundin tjetër", ka thënë Klopp.

#### Guardiola: Ka edhe një ndeshje, të bindemi që mund t'ia dalim

Fitorja 3-0 e Liverpoolit ndaj Manchester Cityt i ka dhënë drejtim kualifikimit të gjysmëfinaleve të Ligës së Kampionëve nga ana e të kuqve. Natyrshëm që ky rezultat ka sjellë tensione dhe një situatë jo të mirë në kapin e "qytetarëve" dhe Guardiola nuk e fsheh hidhërimin. "Asnjë nuk beson se do ta kalojmë turin. Ne do të vetëbindemi se mundemi, pasi sfida ende nuk është mbyllur. Nuk krijuam raste të pastra, pasi ata u mbrojtën mirë. Kishim nevojë për një gol, por nuk ia dolëm ta shënonim. Besoj shumë të skuadra ime. Më ka treguar shumë gjëra të mira përgjatë sezonit. Kemi ende 90 minuta dhe do ta provojmë. Tani të përgatitemi për derbin me Manchester Unitedin", ka thënë Guardiola.

#### Juve i shtohet garës për Griezmannin

Juventusit ka shfaqur interesim për transferimin e sulmuesit të Atletico Madridit, Antoine Griezmann. "Corriere dello Sport" ka njoftuar se skuadra kampione e Italisë ka shfaqur interesim për transferimin e sulmuesit francez në afatin kalimtar të verës. Interesim për Antoine Griezmann kanë shfaqur edhe Manchester Unitedi dhe Barcelona.

#### City kërkon Iscon dhe Kanen

Ylli i Tottenham Hotspurit, Harry Kane dhe mesfushori i Real Madridit, Isco, janë duke u përcjellë me kujdes nga Manchester City. Mesfushori spanjoll është pranë prishjes së marrëdhënies me "Los Blancos" dhe Pep Guardiola do të mundohet ta shfrytëzojë këtë gjë. Raportet thonë se edhe Kane pritet të kalojë tek City, pasi do të pëlqente të luante krah 25-vjeçarit dhe të mos kalojë në Madrid nëse ai shitet.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Valbona Novobërdaliu shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli", në Prishtinë.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040, nenit 4 deri në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016 nga MAPL, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës si dhe nenit 3,4,5,6,7 dhe 8 të Rregullores komunale për Komitete Konsultative /2012, si dhe Vendimit të Komunës së Klinës, nr.01Nr.-06-631/2018 miratuar me 06.02.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës vendosi, të shpall:

**KONKURS PUBLIK  
Për  
ANTARËSIMIN NË KOMITETET KONSULTATIVE TË KOMUNËS**

1. Komiteti për Çështje Emergjente dhe
2. Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Secili Komitet përbëhet nga 5 anëtarë.

**I. KUSHTET DHE KRITERET E ANËTARËSIMIT:**

Anëtarët e Komiteteve konsultative duhet t'i përbushin këto kriterë:

1. Të jenë banorë të Komunës së Klinës,
2. Të kenë përgatitjen superiore-profesionale të fushës përkatëse mundësisht të fakultetit,
3. Të jetë njohës i punës me kompjuter (dëshmia e kurseve përkatëse),
4. Të drejtë aplikacioni kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që i përbushin kushtet.

**PËRSHKRIMI I PUNËVE :**

- Anëtarët e Komiteteve Konsultative duhet të kenë aftësi për paraqitjen e ideve, mendimeve dhe hulumtimeve si dhe dhënien e propozimeve të ndryshme për rregullat komunale dhe iniciativave të ndërmara nga organet komunale,  
-Gjithashtu, këto komitete paraqesin mendimet e qytetarëve të Kryetarit i Komunës dhe Kuvendi i Komunës dhe të japin propozime për probleme të identifikuara,  
-Këto komitete duhet të hartojnë planin e punës dhe kalendarin për takime për secilin vit, në të cilin duhet të përfshijnë takimet e rregullta me kuvendin e komunës si dhe takime të rregullta me Kryetarin e Komunës  
-Komitetet Konsultative obligohen të dorëzojnë raport vjetor për punën e vet Kuvendit të Komunës.

**DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM**

Aplikacioni merret në Shërbimin për punët Kuvendit duke ia bashkangjitur dokumentet tjera si në vijim:

- Diplomën e Fakultetit apo të shkollës së mesme ( të noterizuar),
- Ekstraktin e lindjes,
- Letërnjoftimi i fotokopjuar,
